



UNMIK/RREG/2003/12  
7 maj 2003

---

## RREGULLORE NR. 2003/12

### MBROJTJA KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik të vitit 1999 mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Duke marrë parasysh, mes tjerash, Konventën ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike, Konventën evropiane mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe Konventën ndërkombëtare mbi të drejtat e fëmijëve,

Duke ditur se dhuna në familje, në të gjitha format e saj, nuk mund të tolerohet dhe se duhet të ekzistojë mbrojtja ligjore efektive dhe mekanizmat e ndihmës për viktimat e dhunës në familje,

Me anë të kësaj shpall si vijon:

### KAPITULLI I: Dispozitat e përgjithshme

#### Neni 1 Përkufizimet

Sipas kësaj Rregulloreje:

1.1 “Lidhje familjare” do të thotë lidhja ndërmjet dy personave:

(a) Të cilët janë të fejuar ose të martuar me njëri-tjetrin apo bashkëjetojnë me njëri-tjetrin pa qenë të martuar;

(b) Të cilët përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martesore ose birësimi apo janë në lidhje kujdestarie, duke përfshirë prindërit,

gjyshërit, fëmijët, nipat, vëllezërit e motrat, hallat e tezet, xhaxhallarët e dajallarët, ose kushërinjtë ose

(c) Të cilët janë prindër të një fëmije të përbashkët.

1.2 “Dhunë në familje” do të thotë një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bën një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në një lidhje familjare si këto:

(a) Shkaktimi i lëndimit trupor;

(b) Marrëdhënia seksuale ose keqtrajtimi seksual pa pëlqim;

(c) Qitja e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen e tij apo të saj fizike, emocionale dhe ekonomike;

(d) Rrëmbimi;

(e) Shkaktimi i dëmeve pasurore;

(f) Kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër;

(g) Hyrja me dhunë në pronën e personit tjetër;

(h) Largimi me dhunë i personit tjetër nga banesa e përbashkët;

(i) Ndalimi i personit tjetër për të hyrë ose për të dalë nga banesa e përbashkët ose

(j) Përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përluljes së personit tjetër.

1.3 “Viktimë” do të thotë personi i cili i është nënshtruar dhunës në familje të përcaktuar në nenin 1.2.

1.4 “Kërkues” do të thotë personi i cili paraqet kërkesë për urdhërmbrojtje ose urdhër për mbrojtje emergjente.

1.5 “I paditur” do të thotë personi i cili supozohet se ka kryer një vepër ose më shumë vepra të dhunës në familje kundër të cilit kërkohet urdhri për mbrojtje ose urdhri për mbrojtje emergjente.

1.6 “Pala e mbrojtur” do të thotë personi i cili i është nënshtruar dhunës në familje dhe në të mirë të të cilit është kërkuar urdhëri për mbrojtje ose urdhëri për mbrojtje emergjente.

1.7 “Organi për zbatimin e ligjit” do të thotë Policia Civile e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, e njohur po ashtu si Policia Ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara ose Policia e UNMIK-ut dhe Shërbimi Policor i Kosovës.

1.8 “Avokat i viktimës” do të thotë personi i cili është i autorizuar nga organi kompetent për të mbrojtur interesat e viktimës në cilësinë e përfaqësuesit të autorizuar dhe për t’iu siguruar përkrahje dhe ndihmë viktimave.

1.9 “Fëmijë” do të thotë personi i cili nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet.

## Neni 2

### Masat e urdhëresave për mbrojtje, urdhëresat për mbrojtje emergjente dhe urdhëresat për mbrojtje emergjente të përkohshme

2.1 Urdhëresa për mbrojtje mund:

(a) T’ia ndalojë të pandehurit që mos të kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje ndaj palës së mbrojtur apo personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare;

(b) T’ia ndalojë të pandehurit që mos e trazojë, të mos e ngacmojë, të mos kontaktojë apo të komunikojë drejtpërdrejt a tërthorazi me palën e mbrojtur ose me personin me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare;

(c) T’ia ndalojë të pandehurit që mos t’i ofrohet brenda një distance të caktuar palës së mbrojtur ose personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare;

(d) T’ia ndalojë të pandehurit qëndrimin në vendin e punës së palës së mbrojtur ose në ndonjë vend të caktuar;

(e) T’ia kufizojë të pandehurit që të mos takohet me fëmijën e palës së mbrojtur sipas kushteve të cilat mund të jenë të përshtatshme;

(f) T’ia ndalojë të pandehurit hyrjen ose qëndrimin në banesën e përkohshme a të përhershme të palës së mbrojtur, ose në ndonjë pjesë të saj, pavarësisht nga të drejtat pronësore apo të drejtat e banimit të të pandehurit;

(g) Të urdhërojë ndonjë person të autorizuar që ta shoqërojë palën e mbrojtur ose të pandehurin deri në banesën e palës së mbrojtur dhe të mbikëqyrë largimin e pasurisë personale që i takon atij personi apo ndonjë personi tjetër të caktuar;

(h) Të urdhërojë konfiskimin e armëve (siç është përcaktuar me Rregulloren nr. 2001/7 të UNMIK -ut të datës 21 shkurt 2001 për Autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë), duke përfshirë edhe armët gjuetisë dhe ato të rekreacionit;

(i) T’i urdhërojë të pandehurit që të lejojë palën e mbrojtur të shfrytëzojë banesën të cilën e përdorin së bashku i pandehuri dhe pala e mbrojtur ose ndonjë pjesë të saj;

(j) T’i urdhërojë të pandehurit që të paguajë qiranë ose hipotekën e banesës së përkohshme a të përhershme të palës së mbrojtur ose të paguajë alimentacionin për palën e mbrojtur dhe për ndonjë fëmijë për të cilin i pandehuri ka obligim për ta mbajtur;

(k) T’i urdhërojë palës së mbrojtur që t’i kthehet fëmija i saj;

(l) T'ia jep palës së mbrojtur kujdestarinë e përkohshme për fëmijën e palës së mbrojtur;

(m) T'ia ndalojë të pandehurit ose palës së mbrojtur shitjen e çfarëdo pasurie brenda një periudhe të përkohshme dhe të caktuar;

(n) T'i munëdojë palës së mbrojtur që vetëm ajo të posedojë dhe të shfrytëzojë pasurinë e caktuar personale të palës së mbrojtur;

(o) T'i urdhërojë komisarit të policisë që të pezullojë ose të tërheqë lejen për armëmbajtje të lëshuar në bazë të Rregullores nr. 2001/7 të UNMIK-ut të datës 21 shkurt 2001 për autorizimin e posedimit të armëve në Kosovë ose

(p) Të caktojë ndonjë masë tjetër që është e domosdoshme për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur apo personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare.

2.2 Urdhri për mbrojtje emergjente mund të caktojë një ose më shumë prej masave të përcaktuara në paragrafët (a) – (h) të nenit 2.1.

2.3 Urdhri për mbrojtje të përkohshme emergjente mund të caktojë një ose më shumë nga masat e përcaktuara në paragrafët (a) – (c) të nenit 2.1.

### Neni 3

#### Ndërlidhja me urdhrat tjerë

3.1 Pavarësisht prej ndonjë urdhri tjetër të lëshuar nga gjykata apo ndonjë organ tjetër kompetent, urdhri për mbrojtje, urdhri për mbrojtje emergjente ose urdhri për mbrojtje emergjente të përkohshme mund të lëshohet në përputhje me këtë Rregullore.

3.2 Lëshimi i urdhrat për mbrojtje, urdhrat për mbrojtje emergjente ose urdhrat për mbrojtje emergjente të përkohshme nuk i cenon të drejtat pasurore ose të kujdestarisë së asnjë personi pas skadimit të urdhrat.

### Neni 4

#### Ndihma e përfaqësuesit ligjor

Viktimit dhe të pandehurit mund t'i ndihmojë përfaqësuesi ligjor në të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me urdhrin për mbrojtje, mbrojtjen emergjente ose mbrojtjen e përkohshme emergjente.

## **KAPITULLI II: Urdhrat për mbrojtje dhe urdhrat për mbrojtje emergjente**

### Neni 5

#### Juridiksioni i gjykatës

5.1 Gjykata komunale e cila e ka juridiksionin në komunën ku parashtruesi i kërkesës banon në mënyrë të përhershme ose të përkohësisht është gjykatë kompetente për të shqyrtuar kërkesën për urdhër të mbrojtjes ose urdhër të mbrojtjes emergjente dhe për të lëshuar urdhrin.

5.2 Çdo gjykatë komunale është kompetente për të shqyrtuar kërkesën për urdhër të mbrojtjes ose urdhër të mbrojtjes emergjente dhe për të lëshuar urdhrin, nëse gjykata kompetente sipas nenit 5.1 e ka paraqitur kërkesën për urdhër të mbrojtjes ose urdhër të mbrojtjes emergjente në atë gjykatë dhe nëse ajo gjykatë ka juridiksion në komunën në të cilën pala e mbrojtur e ka ndërruar vendbanimin, ka marrë vendqëndrim të përkohshëm apo nëse kjo bartje i shërben interesit më të mirë të palës së mbrojtur.

5.3 Nëse në gjykatën kompetente është parashtruar lutja në bazë të ligjit për familjen dhe marrëdhëniet martesore, ajo gjykatë është kompetente për të shqyrtuar kërkesën për urdhërmbrojtje ose për urdhërmbrojtje emergjente dhe për të lëshuar urdhrin.

5.4 Shqyrtimin e kërkesës për urdhërmbrojtje ose për urdhërmbrojtje emergjente dhe për lëshimin e urdhrin e bën gjykatësi.

5.5 Gjykata e cila e lëshon urdhrin për mbrojtje ose urdhrin për mbrojtje emergjente është kompetente për të vendosur rreth shkeljes së këtij urdhri sipas nenit 15.

#### Neni 6

#### Kërkesat për urdhërmbrojtje ose urdhërmbrojtje emergjente

6.1 Kërkesën për urdhërmbrojtje mund ta paraqesë:

- (a) Pala e mbrojtur ose
- (b) Përfaqësuesi ligjor i palës së mbrojtur.

6.2 Kërkesën për urdhërmbrojtje emergjente mund ta paraqesë:

- (a) Pala e mbrojtur;
- (b) Përfaqësuesi ligjor i palës së mbrojtur;
- (c) Personi me të cilën pala e mbrojtur ka lidhje familjare;
- (d) Përfaqësuesi i qendrës për punë sociale në komunën ku banon përherë ose opërkohësisht pala e mbrojtur;
- (e) Personi i cili është në dijeni të drejtpërdrejtë për një vepër ose më shumë vepra të dhunës në familje ndaj palës së mbrojtur ose
- (f) Avokati i viktimës me pëlqimin e palës së mbrojtur.

6.3 Lutja për urdhërbrojtje ose urdhërbrojtje emergjente paraqitet me shkrim ose gojarisht sipas ligjit të procedurës kontestimore dhe përfshinë:

- (a) Emrin e gjykatës;
- (b) Emrin, adresën dhe profesionin e kërkuarit dhe të pandehurit;

(c) Emrin dhe adresën e palës së mbrojtur dhe (ose) të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare me palën e mbrojtur i cili duhet të mbrohet me anë të urdhrimit për mbrojtje ose urdhrimit për mbrojtje emergjente dhe lidhja e person(ave)it të tillë me të pandehurin;

(d) Një përshkrim të qartë të materies së kontestit, duke përfshirë arsyen(t) e caktuar se për çka lutësi ka frikë se i pandehuri e ka rrezikuar sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, i cili duhet të mbrohet me anë të urdhrimit për mbrojtje ose urdhrimit për mbrojtje emergjente;

- (e) Masat mbrojtëse të posaçme që kërkohen dhe
- (f) Sipas mundësisë, dëshminë për mbështetjen e kërkesës.

6.4 Lutja e urdhrimit për mbrojtje ose urdhrimit për mbrojtje emergjente mund të paraqitet bashkë me kërkesën e parashtruar sipas ligjit mbi familjen dhe marrëdhëniet martesore.

6.5 Kërkuari lirohet nga taksat e gjykatës.

6.6 Interesat e kërkuarit duhet t'i përfaqësojë avokati i viktimës, me pëlqimin e tij apo të saj, duke përfshirë edhe procesin gjatë ankesës.

6.7 Nëse zbulimi i adresës së përhershme a të përkohshme të kërkuarit të palës së mbrojtur a të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, e i cili duhet të mbrohet me anë të urdhrimit për mbrojtje ose urdhrimit për mbrojtje emergjente do ta rrezikonte atë person(a), atëherë mund të merret një masë ose më shumë masa të mëposhtme:

- (a) Kërkesa duhet sigurojë një adresë alternative;

(b) Adresa tjetër e siguruar në kërkesë duhet të jetë adresa e vetme që paraqitet në dokumentet dhe dosjet publike të gjykatës ose

(c) Nëse gjykatësi vendos se zbulimi i adresës në dosjet e gjykatës është i domosdoshëm, ato dosje në të cilat shkruhet adresa duhet të jenë të mbyllura.

## Neni 7

### Shqyrtimi i kërkesave për urdhërbrojtje

7.1 Gjykata vendos përkritazi me kërkesën për mbrojtje brenda pesëmbëdhjetë ditëve pas pranimit të kërkesës.

7.2 Gjatë shqyrtimit të kërkesës për urdhëmbrojtje, gjykata e mban seancën e dëgjimit në mënyrë që t'i dëgjojë personat në vijim:

- (a) Pala e mbrojtur ose përfaqësuesi i autorizuar;
- (b) I pandehuri ose përfaqësuesi i autorizuar;
- (c) Kërkuesi;
- (d) Përfaqësuesi nga qendra për punë sociale e komunës në të cilën jeton përherë ose përkohësisht personi i përmendur më poshtë në rastin kur:
  - (i) Kërkuesi është i moshës nën tetëmbëdhjetë vjet (18) ose i mungon aftësia juridike ose
  - (ii) Veprat e supozuara të dhunës në familje kanë ndikim në personin i cili është i moshës nën tetëmbëdhjetë vjet (18) ose nuk ka zotësi juridike; dhe
- (e) Dëshmitarë të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.

7.3 Gjkata i thërret menjëherë personat e përmendur sipas nenit 7.2 në bazë të ligjit për procedurën kontestimore. Nëse thirret përfaqësuesi nga qendra për punë sociale, atëherë gjykata po ashtu kërkon nga ky person që ta paraqesë mendimin e tij me shkrim, duke vlerësuar gjendjen e palës së mbrojtur.

7.4 Dëgjimi bëhet në mungesë të të pandehurit nëse individ i është thirrur në mënyrë e duhur dhe nëse lutja është mbështetur me dëshmi të mjaftueshme.

7.5 Lutja konsiderohet si e tërhequr nëse në seancën e dëgjimit nuk paraqiten as pala e mbrojtur e as përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur dhe nëse këta individë janë thirrë në mënyrë e duhur, ndërsa nuk e kanë njoftuar gjykatën për arsyet e mungesës së tyre. Tërheqja e kërkesës nuk parandalon paraqitjen e kërkesës tjetër.

## Neni 8

### Lëshimi i urdhërave për mbrojtje

8.1 Gjkata e lëshon urdhrin për mbrojtje për të caktuar një ose më shumë prej masave të parapara në nenin 2.1, nëse vërteton se:

- (a) Ekzistojnë bazat për të besuar se i pandehuri ka kryer ose është kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje dhe
- (b) Lëshimi i urdhrin për mbrojtje është i domosdoshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur apo të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare dhe i cili duhet të mbrohet me anë të urdhrin.

8.2 Pavarësisht se a ekziston apo jo ndonjë procedurë penale kundër të pandehurit, ajo nuk duhet të paragjykojë vendimin për lëshimin e urdhrin për mbrojtje.

8.3 Në urdhrin për mbrojtje duhet të ceket:

- (a) Masa e caktuar nga gjykata;
- (b) Kohëzgjatja e urdhrin për mbrojtje, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj;
- (c) Vërejtja se shkelja e urdhrin për mbrojtje është vepër penale;
- (d) Njoftimi për të drejtën e ankesës kundër urdhrin për mbrojtje brenda tetë (8) ditëve prej marrjes së tij dhe
- (e) Njoftimi se të pandehurit mund t'i ofrojë ndihmë përfaqësuesi ligjor.

8.4 Urdhri për mbrojtje i lëshuar nga gjykata duhet t'i dërgohet menjëherë të pandehurit në bazë të ligjit për procedurën kontestimore.

8.5 Gjykata u dërgon personave në vijim nga një kopje të urdhrin për mbrojtje brenda njëzet e katër (24) orëve pas lëshimit të tij:

- (a) Palës së mbrojtur dhe personave të tjerë emrat e të cilëve janë shënuar në urdhrin për mbrojtje;
- (b) Kërkuesit;
- (c) Stacionit lokal të policisë në lokalitetin ku jetojnë përherë ose përkohësisht pala e mbrojtur dhe personat tjerë të përmendur në urdhrin për mbrojtje dhe
- (d) Qendrës për punë sociale në komunën ku pala e mbrojtur dhe personat tjerë të përmendur në urdhër për mbrojtje jetojnë përherë ose përkohësisht.

8.6 Urdhri për mbrojtje hyn në fuqi menjëherë pas lëshimit nga ana e gjykatës dhe fillon të zbatohet ndaj të pandehurit pasi t'i jetë dorëzuar personalisht atij në bazë të ligjit për procedurën kontestimore.

### Neni 9

#### Shqyrtimi i kërkesave për urdhresa të mbrojtjes emergjente

9.1 Gjykata vendos përkitazi me kërkesën për mbrojtje emergjente brenda njëzet e katër (24) orëve pas parashtrimit të kërkesës.

9.2 Me rastin e shqyrtimit të kërkesës për një urdhërmbrojtje emergjente, gjykata duhet të mbajë një seancë që të dëgjohen personat vijues:

- (a) Pala e mbrojtur ose përfaqësuesi i autorizuar;
- (b) I pandehuri ose përfaqësuesi i autorizuar;
- (c) Këkuesi dhe

(d) Çfarëdo dëshmitarësh të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.

9.3 Sipas nevojës, gjykata mund ta bëjë dëgjimin në mungesë të të pandehurit.

9.4 Gjykata i thërret menjëherë personat e përmendur sipas nenit 9.2, konform ligjit mbi procedurën kontestimore.

## Neni 10

### Lëshimi i urdhrave për mbrojtje

10.1 Gjykata e lëshon urdhrin për mbrojtje për të caktuar një ose më shumë prej masave të parapara në paragrafët (a) – (h) të nenit 2.1 nëse vërteton se:

(a) Ekzistojnë baza për të besuar se i pandehuri ka kryer ose është kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje;

(b) I pandehuri paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të pashmangshëm për sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur dhe personi me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare dhe i cili duhet të mbrohet me anë të urdhrin për mbrojtje dhe

(c) Lëshimi i urdhrin për mbrojtje emergjente është i domosdoshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, e të cilët duhet të mbrohen me anë të urdhrin për mbrojtje.

10.2 Pavarësisht se a ekziston apo jo ndonjë procedurë penale kundër të pandehurit, ajo nuk duhet të paragjykojë vendimin për lëshimin e urdhrin për mbrojtje emergjente.

10.3 Në urdhrin për mbrojtje duhet të ceket:

(a) Masa e caktuar nga gjykata;

(b) Kohëzgjatja e urdhrin për mbrojtje emergjente, e cila skadon në fund të dëgjimit për vërtetimin e urdhrin për mbrojtje emergjente;

(c) Vërejtja se shkelja e urdhrin për mbrojtje emergjente është vepër penale dhe

(d) Data e dëgjimit për vërtetimin e urdhrin për mbrojtje emergjente, e cila duhet të jetë brenda njëzetë (20) ditëve prej lëshimit të urdhrin për mbrojtje emergjente;

(e) Njoftimi se të pandehurit mund t'i ofrojë ndihmë përfaqësuesi ligjor.

10.4 Urdhri për mbrojtje emergjente i lëshuar nga gjykata duhet t'i dërgohet menjëherë të pandehurit në bazë të ligjit për procedurën kontestimore.

10.5 Gjykata u dërgon personave të mëposhtëm nga një kopje të urdhrin për mbrojtje emergjente brenda njëzetë e katër (24) orëve pas lëshimit të tij:

(a) Palës së mbrojtur dhe personave të tjerë, emrat e të cilëve janë shënuar në urdhrin për mbrojtje emergjente;

(b) Kërkuesit;

(c) Stacionit lokal të policisë në vendin ku pala e mbrojtur dhe personat tjerë të përmendur në urdhër për mbrojtje emergjente jetojnë përherë ose përkohësisht dhe

(d) Qendrës për punë sociale në komunën në të cilën pala e mbrojtur dhe personat tjerë të përmendur në urdhër për mbrojtje emergjente jetojnë përherë ose përkohësisht

10.6 Urdhri për mbrojtje emergjente hyn në fuqi menjëherë pas lëshimit nga ana e gjykatës dhe fillon të zbatohet ndaj të pandehurit pasi t'i jetë dorëzuar personalisht atij në bazë të ligjit mbi procedurën kontestimore.

10.7 Gjatë dëgjimit për vërtetimin e urdhrin për mbrojtje emergjente, gjykata duhet të vazhdojë punën në bazë të nenit 7. Në fund të dëgjimit, gjykata mund:

(a) Të jep urdhër për përfundimin e urdhrin për mbrojtje emergjente ose

(b) Të lëshojë urdhrin për mbrojtje në bazë të nenit 8. Sipas nevojës, ky urdhër për mbrojtje mund t'i ndryshojë kushtet e urdhrin për mbrojtje emergjente.

#### Neni 11

##### Ankesat

11.1 Ankesa kundër vendimit përkitazi me kërkesën e urdhrin për mbrojtje ose vendimit për vërtetimin e urdhrin për mbrojtje emergjente duhet të parashtrohet brenda tetë (8) ditëve nga dita kur është lëshuar urdhri.

11.2 Parashtrimi i ankesës nuk e ndalon ekzekutimin e urdhrin për mbrojtje.

#### Neni 12

##### Ndryshimi, ndërprerja dhe vazhdimi

12.1 Nëse rrethanat kanë ndryshuar rrënjësisht, pala e mbrojtur ose i pandehuri mund të parashtrorjë kërkesë për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrin për mbrojtje.

12.2 Pas marrjes së kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrin për mbrojtje, gjykata vazhdon me shqyrtimin e kërkesës në bazë të nenit 7. Në fund të shqyrtimit, gjykata mund:

(a) Të vendosë që urdhri për mbrojtje të mbetet në fuqi;

(b) Të vendosë që urdhri për mbrojtje të ndryshohet, nëse kjo kërkohet nga rrethanat që kanë ndryshuar rrënjësisht ose

(c) Të vendosë që urdhri për mbrojtje të ndërpritet, nëse kriteret e përcaktuara në nenin 8.1 nuk vlejné më për shkak të ndryshimit rrënjësor të rrethanave.

12.3 Parashtrimi i kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrin për mbrojtje nuk e pezullon ekzekutimin e urdhrin për mbrojtje.

12.4 Pesëmbëdhjetë (15) ditë para skadimit të urdhrin për mbrojtje, pala e mbrojtur ose përfaqësuesi i autorizuar i tij a i saj mund të parashtojë kërkesën për vazhdimin e urdhrin për mbrojtje. Nëse nuk parashtrohet lutja për vazhdimin e urdhrin për mbrojtje, ai ndërpritet automatikisht në ditën e skadimit.

12.5 Pas marrjes së kërkesës për vazhdimin e urdhrin për mbrojtje, gjykata vazhdon me shqyrtimin e kërkesës në bazë të nenit 7. Në fund të shqyrtimit, gjykata mund:

(a) Të vërtetojë ndërprerjen e urdhrin për mbrojtje në datën e skadimit të tij ose

(b) Të vendosë që të vazhdohet urdhri për mbrojtje, nëse vlejné kriteret e përcaktuara në nenin 8.1

12.6 Përkitazi me urdhërat e lëshuar në bazë të këtij neni do të vlejné nenet 8.4 deri 8.6. Nëse gjykata vendos për ndryshimin ose vazhdimin e urdhrin për mbrojtje në bazë të neneve 12.2(b) ose 12.5(b), do të vlejë po ashtu neni 8.3.

### **KAPITULLI III: Kompetenca dhe përgjegjësitë e organeve për zbatimin e ligjit**

#### Neni 13

#### Urdhrat për mbrojtjen e përkohshme emergjente

13.1 Jashtë orarit të punës së gjykatave, kërkesa për urdhër të mbrojtjes së përkohshme emergjente mund t'i paraqitet organeve të zbatimit të ligjit nga:

(a) Pala e mbrojtur;

(b) Përfaqësuesi ligjor i palës së mbrojtur;

(c) Personi me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare;

(d) Përfaqësuesi i qendrës për punë sociale në komunën ku banon përherë ose përkohësisht pala e mbrojtur ose

(e) Personi i cili është në dijeni të drejtpërdrejtë për një vepër ose më shumë vepra të dhunës në familje ndaj kërkuesit.

13.2 Komandanti kujdestar ose ushtruesi i detyrës së komandantit të njësitit rajonal të policisë së UNMIK-ut për dhunë në familje mund të lëshojë urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente dhe të caktojë një ose disa prej masave të përmendura në paragrafët (a) – (c) të nenit 2.1 të kësaj Rregulloreje, nëse ai ose ajo vërteton se:

(a) Ekzistojné baza për të besuar se i pandehuri ka kryer ose është kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje;

(b) I pandehuri paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të atypëratyshëm për sigurinë, shëndetin a mirëqenien e palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, të cilët duhet të mbrohen me anë të urdhrin për mbrojtje dhe

(c) Lëshimi i urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente është i domosdoshëm për të siguruar shëndetin ose mirëqenien e palës së mbrojtur ose të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, e që duhet të mbrohen me anë të urdhrin për mbrojtje.

13.3 Në urdhrin për mbrojtje duhet të ceket:

(a) Masa e caktuar nga komandanti kujdestar ose ushtruesi i detyrës së komandantit rajonal të njësitit të policisë së UNMIK-ut për dhunën në familje;

(b) Kohëzgjatja e urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente, e cila skadon në fund të ditës së ardhshme gjatë të cilës gjykata punon;

(c) Vërejtja se shkelja e urdhrin për mbrojtje emergjente të përkohshme është vepër penale dhe

(d) Njoftimi se të pandehurit mund t'i ofrojë ndihmë përfaqësuesi ligjor në procedurën ligjore dhe

(e) Shpjegimi se pas kalimit të afatit për mbrojtje të përkohshme emergjente, pala e mbrojtur mund të paraqesë kërkesë për urdhërmbrojtje emergjente, e cila nëse lejohet, do t'i nënshtrohet mbajtjes së një seance apo paraqitjes së kërkesës për urdhërmbrojtje kundër së cilës mund të bëhet ankesë, nëse lejohet.

13.4 Urdhri për mbrojtje të përkohshme emergjente i lëshuar nga komandanti kujdestar ose ushtruesi i detyrës së komandantit rajonal të njësitit të policisë së UNMIK-ut për dhunën në familje duhet t'i dërgohet menjëherë të pandehurit në pajtim me ligjin e procedurës kontestimore.

13.5 Organet e zbatimit të ligjit u dërgojnë personave në vijim nga një kopje të urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente:

(a) Palës së mbrojtur dhe personave të tjerë, emrat e të cilëve janë shënuar në urdhrin për mbrojtje emergjente;

(b) Kërkuesit;

(c) Stacionit lokal të policisë në lokalitetin ku jetojnë përherë ose përkohësisht pala e mbrojtur dhe personat tjerë të përmendur në urdhër për mbrojtje të përkohshme emergjente;

(d) Qendrës për punë sociale në komunën ku jetojnë përherë ose përkohësisht pala e mbrojtur dhe personat e tjerë të përmendur në urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente dhe

(e) Gjykatës kompetente komunale.

13.6 Urdhri për mbrojtje të përkohshme emergjente hyn në fuqi menjëherë pas lëshimit nga ana e komandantit kujdestar ose ushtruesit të detyrës së komandantit rajonal të njësitit të policisë së UNMIK -ut për dhunë në familje dhe fillon të zbatohet ndaj të pandehurit pasi t'i jetë dorëzuar personalisht atij në bazë të ligjit për procedurën kontestimore.

#### Neni 14

##### Përgjegjësitë e organeve për zbatimin e ligjit

14.1 Organet për zbatimin e ligjit duhet t'i përgjigjen secilit njoftim për veprat ose kërcënimet e dhunës në familje ose shkeljes së urdhrin për mbrojtje apo të urdhrin për mbrojtje emergjente pa marrë parasysh se kush e bën njoftimin.

14.2 Nëse ekziston dyshimi i bazuar se është kryer vepra që ka të bëjë me dhunën në familje, organet për zbatimin e rendit e arrestojnë kryerësin e supozuar dhe e paraburgin sipas ligjit të procedurës kontestimore.

14.3 Organet për zbatimin e ligjit përdorin mjetet e arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar vazhdimin e dhunës, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në:

(a) Informimin e viktimës ose përfaqësuesin ligjor të viktimës për të drejtat e tij në përputhje me këtë Rregullore, por edhe me të drejtën për të kërkuar urdhrin për mbrojtje të përkohshme sipas nenit 13 dhe të drejtat e parapara sipas këtij neni;

(b) Informimin e viktimës lidhur me shërbimet e ndihmës ligjore, psikologjike dhe ndihmave të tjera në dispozicion nga institucionet qeveritare si dhe prej rrjetit të autorizuar të organizatave joqeveritare të cilat ofrojnë shërbime për viktimat;

(c) Informimin e ofruesve përkatës të shërbimeve të përmendura sipas nenit 14.3(b) lidhur me ndonjë rast të dhunës në familje dhe mundësimin e kontaktit mes ofruesit të shërbimit dhe viktimës me kërkesën e viktimës;

(d) Sigurimin ose aranzhimin e transportimit të viktimës dhe vartësve të saj nëpërmjet një agjencie tjetër deri në objektin e duhur mjekësor për trajtim ose kontrollim mjekësor;

(e) Ofrimin dhe ndihmën e viktimës për ta larguar vetëm pronën e nevojshme personale nëse viktima zgjedh të largohet nga banesa familjare që përdoret bashkarisht;

(f) Sigurimin ose aranzhimin e transportimit të viktimës, e sipas nevojës edhe vartësve të saj nëpërmjet një agjencie tjetër deri në një vendstrehim apo venqëndrim tjetër të përshtatshëm dhe të sigurt, me kërkesën e viktimës;

(g) Nëse paraqitet nevoja, sigurimin e mbrojtjes për atë që ka lajmëruar dhunën në përputhje me obligimet përkatëse ligjore lidhur me mbrojtjen e dëshmitarëve;

(h) Largimin e të pandehurit nga banesa e përhershme ose e përkohshme e palës së mbrojtur apo ndonjë pjesë të saj në rastin kur me anë të urdhrit për mbrojtje ose urdhrin për mbrojtje emergjente caktohet masa e paraparë në nenin 2.1(f) ose

(i) Sigurimin e kontaktit zyrtar për viktimën ose përfaqësuesin e saj ligjor me nëpunësin hetues në kuadër të organeve për zbatimin e ligjit nëse kërkohet ndihma e mëtejshme. Nëse mungon nëpunësi hetues, atëherë ndonjë nëpunës tjetër i organeve për zbatimin e ligjit duhet t'i ndihmojë viktimës.

14.4 Organet e zbatimit të ligjit e përpilojnë raportin lidhur me rastin pavarësisht se a është kryer vepra apo jo, a është arrestuar dikush apo jo dhe një kopje të këtij raporti ia japin viktimës ose përfaqësuesit të saj ligjor.

14.5 Nëse viktima është e moshës nën tetëmbëdhjetë vjet (18) ose nuk ka zotësi të plotë juridike, apo kur veprat e dhunës në familje janë aq të rënda sa ndikojnë në qetësinë e sigurinë e personit të moshës nën tetëmbëdhjetë vjet (18), ose që nuk ka aftësi të plotë juridike dhe jeton në banesën e njëjtë, organet e zbatimit të ligjit duhet të raportojnë për rastin menjëherë në qendrën për punë sociale të komunës ku jeton ai person përherë ose përkohësisht.

14.6 Nëse ekziston dyshimi i bazuar se është kryer një vepër që ka të bëjë me dhunën në familje pavarësisht se a është arrestuar kryerësi i supozuar ose është gjetur vendndodhja e tij, organet e zbatimit të ligjit duhet ta njoftojnë rregullisht viktimën apo përfaqësuesin ligjor të viktimës për statusin e hetimeve, duke përfshirë informatat lidhur me vendndodhjen e kryerësit të supozuar ose lirimin e tij a të saj nga burgimi.

## **KAPITULLI IV: Veprat penale dhe procedurat**

### Neni 15

#### Shkelja e urdhrave për mbrojtje, e urdhrave për mbrojtje emergjente dhe urdhrave për mbrojtje të përkohshme emergjente

Kush e shkel në tërësi ose pjesërisht urdhrin për mbrojtje, urdhrin për mbrojtje emergjente ose urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente kryen vepër penale që dënohet me gjobë prej 200 euro deri 2000 euro ose me burgim deri në gjashtë muaj.

### Neni 16

#### Ndjekja e veprave penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje

16.1 Shkelja e urdhrin për mbrojtje, e urdhrin për mbrojtje emergjente ose urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente do të ndiqet automatikisht.

16.2 Nëse është kryer vepra me lëndim të lehtë trupor në kontekstin e dhunës familjare, ajo ndiqet automatikisht.

16.3 Nëse është kryer vepra me dëmtim të pasurisë së tjetrit në kontekstin e dhunës familjare, ajo ndiqet automatikisht.

## **KAPITULLI V: Dispozitat përfundimtare**

### Neni 17 Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjiths hëm mund të lëshojë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

### Neni 18 Ligji në fuqi

18.1 Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

18.2 Dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore zbatohen në rastet kur kjo Rregullore nuk e përcakton ëçshtjen si procedurë të posaçme kontestimore.

### Neni 19 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 7 maj 2003.

Michael Steiner,  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm